



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

SCC-09-0184

Paditësi

V K G.

Kundër

Të paditura

- 1. P “K E”- F K.**
- 2. D “B” L,** përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Sylejman Shumolli dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 20 shkurt 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Padia e paditësit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 06 qershor 2009, paditësi përmes përfaqësuesve të tyre B E dhe M L parashtroj padi për anulimin e kontratës së shitblerjes VR.nr. 2280/63, të dt. 04 shtator 1963 dhe kthimin e paluajtshmerisë.

Me 16 shkurt 2010, përfaqësuesit e paditësit, përmes një shkrese e njoftuan gjykatën se heqin dorë nga përfaqësimi i mëtejme i paditësit në lëndën SCC-09-0184.

Me 22 shkurt 2010, paditësi me parashtrësë e njoftoj gjykatën se ai do ta përfaqësoj personalisht vetveten dhe me te njëjtën datë paraqiti kërkesë për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore.

Me 26 tetor 2022, Gjykata me Aktvendim refuzoj kërkesën e paditësit për lirim nga taksa gjyqësor dhe obligoj paditësin që në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të Aktvendimit të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar paditësin se nëse taksa nuk paguhet brenda afatit të lartcekur, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata beri përpjekje për ta dorëzuar Aktvendimin në fjalë në adresën e paditësit me 28 dhe 31 tetor 2022, por pa sukses, meqë adresa e paditësit ishte e panjohur.

Nga data 11 janar 2023, deri me 19 janar 2023, gjykata bëri publikimin e Aktvendimit në tabelën e shpalljes.

Arsyetimi ligjor

Padia e paditësit konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.4 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Paditësi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Me 26 tetor 2022, Gjykata me Aktvendim refuzoj kërkesën e paditësit për lirim nga taksa gjyqësor dhe obligoj paditësin që në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar paditësin se nëse taksa nuk paguhet brenda afatit të lartcekur, padia do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bej pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Paditësi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Aktvendimi i dt. 26 tetor 2022, ishte tentuar ti dorëzohet paditësit me 28 dhe 31 tetor 2022, në adresën e dhënë nga vet ai si në padi dhe në parashtrësën e 22 shkurt 2010, por nga ana e zyrtarit të postës është konstatuar se adresa e paditësit është e panjohur.

Për me tepër gjykata i zbatoj drejtë procedurat ligjore, ashtu që nga data 11 janar 2023, deri me 19 janar 2023, gjykata bëri publikimin e Aktvendimit të Gjykatës të dt. 26 tetor 2022 në tabelën e shpalljes, konform nenit 26.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe nenit 116,5 dhe 116.6 të LPK-së. Komunikimi i gjykatës me paditësin, i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i rregullt.

Nga arsyet dhëna me lartë paditësi nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues

Sylejman Shumolli, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare